

**VENDIM**  
**Nr. 140/2019**

**PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 84/2019**  
**“PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR**  
**KONTROLLIN E LIGJSHMËRISË SË VEPRIMEVE TË KRYERA NGA ANA E**  
**PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË KUADËR TË**  
**USHTRIMIT TË KOMPETENCAVE TË TIJ LIDHUR ME ZHVILLIMIN E**  
**ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 7 dhe 78, të Kushtetutës, të neneve 3, pika 3, 5, pika 2, dhe 8, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të neneve 55 dhe 112, pika 3, të Rregullores së Kuvendit, rezolutës “Shmangia e krizës kushtetuese me synim legjitimitetin e Gjykatës Kushtetuese – detyrë imperative e organeve më të larta të Shtetit”, kërkesës së 55 deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste “Për shtimin e objektit të Komisionit Hetimor”, si dhe kërkesës të Komisionit Hetimor “Për zgjatjen e afatit të Komisionit Hetimor”,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në vendimin e Kuvendit nr. 84/2019 “Për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore” bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

I. Titulli i vendimit ndryshohet dhe bëhet si me poshtë:

“Për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, si dhe për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve dhe procedurës të ndjekur nga Presidenti i Republikës në kuadër të emërimit të gjyqtarëve kushtetues”.

II. Në pikën III “Objekti i punës së Komisionit Hetimor”, pas shkronjës “ç” shtohen shkronjat “d” dhe “dh” me këtë përmbajtje:

“d) kontrolli i ligjshmërisë së veprimeve dhe procedurës së ndjekur nga Presidenti i Republikës në kuadër të emërimit të gjyqtarëve kushtetues;

dh) shqyrtimi dhe vlerësimi i pasojave që vijnë nga veprimet dhe procedura e ndjekur nga Presidenti i Republikës në kuadër të funksionimit të Gjykatës Kushtetuese.”.

III. Pika VI ndryshohet si më poshtë:

“VI. Afati i veprimtarisë së Komisionit Hetimor zgjatet 4 muaj nga data e mbarimit të afatit të parashikuar në vendimin nr. 112/2019 të Kuvendit, “Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit Hetimor të Kuvendit “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore””.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 5.12.2019.